

**TREGIME**

BIBLIOTEKA

E

854-32

K 89

GJIROKASTËR

SHTETIT



**SHQETESIME  
TE  
NGJASHME**

**FATOS KONGOLI**

891.P83-32

S


K 89

FATOS KONGOLI

SHOETËSIME  
TË NGJASHME

Tregime

~~52273~~



1545

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## NJË RAST NGA PRAKTIKA

Ngjarja që do t'ju tregoj nuk është e jashtëzakonshme. Ne mjekët e lokaliteteve dëgjojmë çdo ditë për gjëra të tilla dhe ndonjëherë mësohemi me një gjendje jo të natyrshme. Fjala vjen, një ditë më thanë se rrugës, duke ardhur në spitalin tonë krahnor, kishte vdekur një burrë. Fshatarët që e shoqëronin thoshin se i qenë ngatërruar zorrët prej disa ditësh, ndërsa unë vura re se ai kishte një apandisit akut. Pra me një operacion të thjeshtë, këtu në spitalin tonë, ai me siguri do të kishte shpëtuar po të kishte ardhur me kohë. Ju do të pyetni se përse s'erdhi?! Këtu qëndron e gjithë puna. Ndodh që njerëzit rrezikohen fare kot, nga një pakujdesi e çuditshme, në një kohë kur edhe në skajin më të largët ka ente mjekësore. Me diçka të tillë ka lidhje edhe ngjarja, që më ndodhi në fshatin B...

Ç'është e vërteta, unë kalova andej rastësisht. Kthehesha nga një fshat tjetër ku vizitova një grua, që kishte lindur në shtëpi të saj dhe ndodhej në gjendje të rëndë. Po rrija ulur në karrige përpara ambulancës me infermierin e fshatit, një djalë i ri vendas. Mendjen e kisha te gruaja.

Isha mjaft i lodhur. Vapa e korrikut digjte e përzhiste dheun e plasaritur të kodrës, gjethet e thara të pemëve të shpërndara andej-këtej. Por më tepër më mërziste infermieri me bisedat e tij. E dëgjoja instinktivisht, pa e patur mendjen në ato fjalë, që më tingëllonin të largëta, të shurdhëta. Bile, habitesha se si guxonte të fliste marrëzira të tilla. Më qahej që s'i kishte ecur fati në jetë, që këtu njerëzit nuk e kuptonin, nuk e përfillnin, se dëshironte të largohej në një vend tjetër. Unë e dëgjoja në heshtje duke pirë duhan dhe vështroja përparësen e tij të bardhë. Ai mund të bënte çdo gjë, por kurrën e kurrës punën e infermierit.

— Janë injorantë këta, doktor, — më thoshte — nuk të çmojnë fare.

Më erdhi t'i jepja një shuplakë. Ai fliste kështu për fshatarët e tij, me të cilët qe rritur. U bëra gati të derdhja tërë atë pakënaqësi, që m'u mblodh në shpirt, por atë çast, në kthesën pas kodrës, u dukën dy fëmijë duke vrapuar. Ata mezi merrnin frymë dhe sytë, që shprehnin një ndjenjë tmerri, i kishin të përlotur.

— Ç'ka ndodhur? — i pyeta.

Ata qëndronin akoma të hutuar dhe ja nisën përsëri të qarit, Atëhere infermieri e zuri njërin prej tyre nga supet, e shkundi fort dhe i bërtiti:

— Hë, more, ç'ka ndodhur që thërrisni kështu?!

— Gjarpri, — foli fëmija i trembur — gjarpri zuri Islamën.

Infermieri, që akoma e shtrëngonte fëmijën e shtangur me duart e tij të fuqishme, e pyeti me zë të vrazhdë:

— Ku e zuri, folë!

— Në stanet, sipër. Tani po e sjellin poshtë.

Vështrova tutje mbi brezin e gjelbër të dush-geve ku shtrihej një krastë laramane dhe sipër saj stanet. Kasollet e barinjve dukeshin si njolla të murme, që roniteshin nën rrezet e forta të diellit.

Pas pak, po në atë kthesë, u duk një burrë i gjatë, që tërhiqte pas vetes një grua. Burri me fytyrë të parruar kushedi prej sa ditësh ecte i qetë, ndërsa gruaja e zverdhur mezi i hidhte këmbët, sikur zvarrisej. Vura re se njërin gisht e kishte të çarë dhe akoma i kullonte gjak, një gjak i zi me ngjyrë të pështirë.

— Kot së koti, — foli burri me një zë të mbytur — shkon e m'i fut duart midis shkarpave.

Gruaja s'fliste dhe mezi qëndronte në këmbë me një pamje të venitur.

— Shpejt, — thirra unë — serumin.

E zura gruan nga dora e plagosur, ja shkëputa me forcë burrit, që akoma e shtrëngonte dhe u sula bashkë me të në infermieri. E shtriva mbi krevat dhe thirra përsëri:

— Serumini, Sali, shpejt serumin...

Fytyra e gruas u mbulua nga pika të mëdha djerse. Zemra i rrihte shpejt.

— Më vjen për të vjellë — tha me një fije zëri.

— Serumini, serumini! — thirra përsëri, por këtë radhë më fort, ndërsa i lidha krahun pak sipër kyçit të dorës.

Infermieri qëndronte në këmbë i hutuar dhe belbëzonte nëpër dhëmbë diçka, që s'po e kuptoja.

— Serumet i kemi të skaduara, doktor, nuk bëjnë.

Unë s'u besova veshëve. Më inatosi ajo fjalë «doktor», që ai ma kishte përsëritur tërë ditën me një servilizëm të shtirë.

— Çfarë!.. — thashë i topitur — Serumet janë të skaduara?!

Më pushtoi një zemërim i brendshëm, që mezi munda ta përmbaja. Qe një rast i jashtëzakonshëm, i padëgjuar, që pikërisht në një ambulancë fshati serumet kundër helmimit të ishin të skaduara.

Fillova të ecja me hapa të mëdhenj në dhomën e vogël të ambulancës, me duar të lidhura pas shpine. Gruaja qëndronte në shtrat dhe rënkonte lehtë, infermieri me një pamje indiferente rrinte pranë dollapit të ilaçeve, ndërsa burri me mjekër të parruar kishte zënë derën e dhomës dhe vështronte nga unë.

— Kjo është e tmerrshme, — i thashë infermierit me zë të ulët — për këtë ti mban përgjegjësi. Ta dish... në qoftë se kjo grua... .

Desha t'i thosha se do ta hidhja në gjyq, por aty për aty u pendova që përmenda fjalën vdekje. Veç kësaj kërcënimi im nuk kishte asnjë kuptim.

Në dhomë pllakosi një heshtje e tmerrshme. Vapa u bë e padurueshme.

— Lermani mua, — tha më në fund burri — dimë edhe ne ca marifete

— Çfarë e ke, — e pyeta — grua?

— Jo, — m'u përgjegj — s'e kam gjë.

— Kur e zuri gjarpri?

— Ka më tepër se gjysmë ore. Ishte nepërkë.. Ajo mbliidhte shkarpa te stanet dhe... Unë ja çava menjëherë me brisk. Pastaj ja thitha. Ndoshta shpëton... .

Më kaluan mornica. Ka më tepër se gjysmë ore... nepërkë... ja çava... Ai fliste sikur të mos kishte ndodhur asgjë.

— Të telefonojmë, — thashë — të marrim spitalin e qytetit për maqinën.

Si distancë më afër qe spitali ynë i lokalitetit, por gjer atje duheshin katër orë më këmbë nëpër atë diell, që digjte si saç. Po ta dërgonim atje, gjendja e saj do të keqësohej mjaft nga rruga. Ndërsa maqina për një orë e gjysmë mund të vinte nga qyteti. Këto i mendova fluturimthi dhe u vër-sula te telefoni.

Në sheshin jashtë ambulancës qe grumbulluar një turmë e madhe njerëzish, që gumëzhinte. Disa vështronin përmes dritares, disa qëndronin te dera. Vrapova në zyrën e këshillit ku ndodhej telefoni dhe rrotullova me nxitim dorezën.

— Alo — dëgjova një zë të largët — kush jeni?

— Jam Halimi, — thirra — mjeku. Jam në B. Të lutem më lidh me qytetin. Kam një rast urgjent, tepër urgjent...

U shpjegova atyre të spitalit si qe puna dhe ata më premtuan se do ta nisnin maqinën e urgjen-cave sapo të kthehej.

I hodha orës një vështrim dhe llogarita se ma-qina mund të vinte pas dy orësh. Ndërkaq mund ta nxirrja gruan gjer në rrugën malore që mbante rreth një orë prej këtej. Aty do të prisnim.

Pas kësaj sikur u qetësova. Sado i fortë të qe helmi, kishte akoma kohë për të dhënë ndihmën. Nxora paqetën, ndeza një cigare, e thitha me tërë mushkëritë dhe u nisa për në ambulancë. Aty nje-rëzit e grumbulluar bisedonin me zë të ulët dhe, kur u kalova pranë, më hapën rrugën. Por gruaja nuk qe më në dhomë. Edhe burri me mjekër të parruar qe zhdukur. Vetëm infermieri, që tashmë e kishte

humbur torruan, qëndronte në këmbë dhe më vështronte si i zënë në faj.

— Ç'u bë gruaja? — e pyeta.

— Iku.

— Si iku!?

— Iku pra, s'kisha ç'të bëja. Erdhi dhe e mori i kunati. E dërguan në shtëpi.

Ai ngriti supet përpjetë si të donte të thoshte se gjëra të tilla ishin fare të natyrshme. Brenda disa çastesh e tërë qenja e tij kishte ndryshuar. Tanimë në fytyrë nuk i dallohej ajo ndjenjë fodulle me të cilën kishte qëndruar ulur mbi karrige përpara ambulancës. E kuptova se prej tij nuk mund të prisja asnjë ndihmë, prandaj e lashë dhe dola jashtë.

— Ku e ka shtëpinë ajo gruaja? — pyeta një plak.

— Poshtë, o doktor, poshtë, te mulliri e ka.

— Mban shumë prej këtej?

— Ndonjë gjysmëore... Po kot e ke!

— Si kot...!?

— Po ja, s'duan ta lënë të vejë në spital. «Ç'ka për t'u bërë, të bëhet këtu», thonë... «Edhe në vdes, më mirë...»

— Kush tha se do të vdesë, more, a jeni në vete.

Njerëzit heshtën.

— Kush do të vijë me mua? — u thirra. — Duhet ta shpëtojmë atë grua.

— Vijnë ne, doktor, — tha njëri — ja dimë ne shtëpinë.

U nisëm pothuajse me vrap tatëpjetë kodrës. Këmbët na u copëtuan në gurët e thepisur dhe po na zihej fryma nga afshi i nxehtë. Kur u futëm në



lagjen e poshtme të fshatit, vura re se të tërë qenë ngritur në këmbë. Një turmë fëmijësh qëndronte mbi një sop përpara shtëpisë ku ndodhej gruaja fatkeqe dhe vështronin njerëzit, që hynin e dilnin. Në prak kishin qëndruar ca burra, që pinin duhan dhe bënin muhabet. Me të më parë, ata u ngritën në këmbë.

— Ku ndodhet? — pyeta njërin.

— Brenda është, në dhomën e grave.

Ata me vështruan me dyshim.

— E ç'do të bësh, doktor?

— Cili është i shoqi?

Fola me nervozizëm dhe e kuptova se s'po bëja mirë, por nuk e di përse nuk isha në gjendje të përmbaja veten.

— I shoqi s'është këtu, — tha njëri — ka vajtur në qytet me kafshët. Ç'e do ti?

— Dua që kjo grua të dërgohet urgjent në spital. Kuptoni? Çdo vonesë kushton shtrenjt.

Asnjëri prej tyre s'u përgjegj. Pastaj dikush foli:

— Punë që s'bëhet ajo, bre doktor. Islami, dua të them burri i saj, s'është këtu. Si mund ta nisim pa llafin e tij?

— Ç'hyn Islami në këtë mes, o Brahim? — tha njëri nga ata që kishin ardhur me mua. — Tjetra është në rrezik e ti më këput profka.

— Si, ore, ç'hyn? — u përgjegj ai. — Është gruaja e tij. Vetëm ai mund të vendosë për këtë...

Mua s'm'u durua dhe u futa brenda. Mezi munda të gjeja në gjysmerrësirë dhomën ku ndodhej e plagosura. Aty qe një rrëmujë e vërtetë. Nja dhjetë gra të reja e plaka i qenë grumbulluar rreth kokës gati për t'i zënë frymën. Flisnin me zë të lar-

të, jepnin e merrnin, ndërsa në qoshe të dhomës tri fëmijë të vegjël rrinin ndenjor kokë më kokë e qanin. Si duket qenë fëmijët e saj. Mua më theri në zemër tek i pashë fëmijët të përlotur dhe fillova t'i shtyja gratë njëra pas tjetrës. Një plakë e thyer kishte mbajtur kokën e saj në pëqi, ndërsa një burrë e kishte zënë nga dora. Gruaja rënkonte, ngjyra e fytyrës i kish ikur fare dhe sytë i qenë venitur.

— Dilni jashtë, — u thirra grave — ju po ja merrni frymën.

Ato u larguan të hutuara. Ahere vura re se dora e plagosur i qe enjtur së tepërmi, i qe mavijosur dhe mbushur me blana të kuqërremta. Nja tri shushunja të zeza, të ngjitura pas lëkurës së nxirë, qenë fryrë si tollumbace.

— Hiqja shushunjat, — i thashë plakës — nuk i sjellin dobi.

— Ja lamë me lëng qinglash — foli ajo me një zë të përvaishëm.

— As ajo s'i bën dobi, nëno, — i thashë — duhet shpënë në spital.

Ajo u step. Një shprehje frike i kaloi nëpër fytyrë. Burri s'u ndie.

— Korba, more bir, po Islami s'është këtu.

— Ç'punë ka Islami, moj nëno — i thashë. — Ti ke nusen në rrezik.

— Ashtu është, por...

— Çfarë por!

— S'e nisim dot. Më mirë të provojmë ta shërojmë vetë.

— Moj nëno! — i thashë përsëri me një zë të përmbajtur — A e kupton se nusen e ke në rrezik, apo jo. Këtu s'kemi ç'i bëjmë as unë, as ti, as Islami yt. Dëgjon?